



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**  
**“HAXHI ZEKA”** në Pejë

**DORACAKU I PUNËSIMIT PËR STAF  
ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN  
“HAXHI ZEKA” NË PEJË**



## **RËNDËSIA E MARRËDHËNIEVE INDIVIDUALE TË PUNËS**

Puna është një veprimtari jetike e individëve të aftë për punë. Ajo është burimi i të ardhurave që ata sigurojnë mjetet e jetesës. Gjithashtu, puna është edhe veprimtari sociale për individët në moshë për të punuar. Secili që ka një punë kërkon të jetë i mbrojtur gjatë kohës që shpenzon për kryerjen e saj,

## **E DREJTA PËR PUNË DHE MARRËDHËNIET NË PUNË**

Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës.

Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi.

# ORGANET DREJTUESE TË UNIVERSITETIT “HAXHI ZEKA” NË PEJË

- **KËSHILLI DREJTUES:**

Këshilli Drejtues i Universitetit është autoriteti kryesor qeverisës i Universitetit. Këshilli Drejtues përbëhet nga shtatë (7) anëtarë me të drejtë vote. Masht emëron tre (3) anëtarë me të drejtë vote dhe Senati zgjedh katër (4) anëtarë të Këshillit Drejtues me të drejtë vote nga personeli akademik i Universitetit. Rektori dhe Sekretari i përgjithshëm janë anëtarë ex-officio të Këshillit Drejtues, pa të drejtë vote.

- **REKTORI:**

Rektori është autoriteti kryesor menaxhues i Universitetit. Rektorin e zgjedh Këshilli Drejtues me konkurs publik, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Statutin e Universitetit.

- **SENATI:**

Senati i Universitetit është organi më i lartë akademik i Universitetit.

## Kategoritë e personelit të Universitetit sipas Ligjit për Zyrtarët Publikë janë:

### NËPUNËSI I SHËRBIMIT PUBLIK;

**Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtëpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike.

- Marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës.

Nëpunës i Shërbimit Publik mund të themelojnë marrëdhënje të punës

- për periudhë të pacaktuar dhe
- për periudhë të caktuar
- për punë dhe detyra specifike përmes zhvillimit të konkursit publik

Hapja e procedurës së konkurrimit shpallet nga NJBNJ, në ueb faqen e konkurrimeve të SIMBNJ, të paktën 30 ditë para datës së planifikuar për paraqitjen e aplikimit nga kandidatët e interesuar

Konkurrimi zhvillohet në këto dy faza:

1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të posaçme, sipas shpalljes së konkurrimit;
2. vlerësimi i njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve

Kohëzgjatje më e vogël, e punës provuese është **6 muaj** për kontratat me periudhë të pacaktuar; dhe **1/5** e kohëzgjatjes të kontratës me periudhë të caktuar

## KRITERET E PËRGJITHSHME DHE KATEGORITË E PERSONELIT

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë në përputhje me: Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, tëpushuar sipas këtij ligji.
- Të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës; dhe
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas këtij ligji.

## Si veprohet para nënshkrimit të një kontrate pune ?

### Informimi

- Për të nënshkruar një kontratë pune si rregull duhet që punëdhënësi të vërë në dispozicion të punëmarrësit një kopje të kontratës së punës për t'u njohur me të.

### Sqarimi

- Çdo punëmarrës ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi, që buron nga kontrata e punës.

### Këshillimi

- Çdo punëmarrës ka të drejtë që të këshillohet me një ekspert të fushës ligjore para se të nënshkruajë kontratën.

### Nënshkrimi

Përpara se të nënshkruhet kontrata e punës duhet të tregohet kujdes:

Lexoni me kujdes kontratën

Kërkoni ndihmën dhe sqarimin e një juristi apo dikujt ndaj të cilit keni besim;

Bëni një kopje të kontratës suaj që mund ta përdorni duke ruajtur origjinalen

Çdo punonjës duhet të nënshkruajë kontratën e punës dhe të mbajë një kopje të saj;

Mos harroni të nënshkruani në çdo faqe të saj apo anekset;

Kërkoni gjithmonë kopjen tuaj origjinale të kontratës së nënshkruar nga punëdhënësi

Duhet që të kuptoni, sqaroni dhe diskutoni gjërat e paqarta

## Përmbajtja e Kontratës së Punës

të dhënat për punëdhënësin (emërtimi, selia dhe numrin e regjistrimit të biznesit

të dhënat për të punësuarin (emri, mbiemri, kualifikimi dhe vendbanimi);

emërtimin, natyrën, llojin e punës, llojin shërbimeve dhe përshkrimin e detyrave të punës;

vendin e punës dhe njoftimin që puna do të kryhet në lokacione të ndryshme

orët dhe orarin e punës

datën e fillimit të punës

kohëzgjatjen e Kontratës së Punës

lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër

kohëzgjatjen e pushimeve

përfundimin e marrëdhënies së Punës;

të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë të përcaktuara me Kontratën e Punës, rregullohen me dispozitat e ligji të punës, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit

të dhëna të tjera për të cilat punëdhënësi dhe punëmarrësi i vlerësojnë të rëndësishme për rregullimin e marrëdhënies së punës

kontrata e Punës mund të përmbajë të drejta dhe detyra të tjera të parashikuara me ligj

MBROJTJA E NËPUNËSIT TË  
SHËRBIMIT PUBLIK



Zyrtari i shërbimit publik mund të  
anohet te punëdhënësi kur  
pretendon se i janë shkelur të  
drejtat në marrëdhënien e punës.  
Të drejtën e ankimit e kanë dhe  
kandidatët në procedurën e  
konkurimit



Shqyrtimi i ankesave është në  
kompetencën e Komisionit të  
Ankesave



Ankimi paraqitet brenda  
pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga  
njoftimi i vendimit



Ankesa shqyrtohet brenda  
pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga  
paraqitja e saj.



Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur  
me vendimin e organit të ankimit  
apo në rast se nuk merr përgjigje  
brenda afatit të përcaktuar më  
larte, në afatin vijues prej  
pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund  
të iniciojë kontest pune në  
gjykatën kompetente



# NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:

1. me vdekjen e të punësuarit;
2. me vdekjen e punëdhënësit, kur puna e kryer apo shërbimet e ofruara nga punëtori janë të natyrës personale, atëherë kur kontrata nuk mund të vazhdohet me pasardhësit e punëdhënësit;
3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;
4. kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gjashtëdhjetë e pesë (65) vjeç;
5. në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për vërtetimin e humbjes së aftësive për punë;
6. nëse i punësuari shkon në vuajtje të dënimit i cili do të zgjasë më tepër se gjashtë (6) muaj;
7. me vendimin e gjykatës kompetente, vendim që pason ndërprerjen e marrëdhënies së punës;
8. me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes;
9. rastet e tjera të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi.

### ME MARRËVESHJE

Kontrata e Punës mund të ndërpritet me marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit bëhet në formë të shkruar

## NDËRPRERJA E KONTRATËS SË PUNËS

### NGA ANA E PUNËDHËNËSIT

Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:  
ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;  
i punësuarit nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;

### NGA I PUNËSUARI

I punësuarit me kontratë në kohë të caktuar për ndërprerjen e kontratës së punës, duhet ta informojë punëdhënësin paraprakisht në formë të shkruar në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa i punësuarit me kontratë në kohë të pacaktuar në afatin prej tridhjetë (30) ditësh

### LARGIMI I PËRKOHSHËM NGA PUNA

- I punësuar mund të largohet përkohësisht nga puna, kur:
  - 1. ndaj tij kanë filluar procedurat penale për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale;
  - 2. i punësuar është në vuajtje të paraburgimit;
  - 3. kryen shkelje të obligimit të punës të përcaktuara me këtë ligj.

### MASAT DISIPLINORE PËR SHKELJEN E DETYRAVE TË PUNËS

- Për shkeljen e detyrave të punës, të punësuarit do t'i shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese:
  - 1. vërejte me gojë;
  - 2. vërejtje me shkrim;
  - 3. ulje në pozitë;
  - 4. suspendim të përkohshëm;
  - 5. ndërprerje të marrëdhënies së punës

### LIRIA E ORGANIZIMIT SINDIKAL

- Të punësuarve dhe punëdhënësve u garantohet liria e asocimit dhe veprimit pa ndërhyrje nga asnjë organizatë ose organ publik;
- Të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal në Republikën e Kosovës rregullohen me ligj të veçantë

### E DREJTA E GREVËS

Për mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve, organizatat e të punësuarve (sindikatat) kanë të drejtën e organizimit të grevës;